



Kurbani dhe çeshtje që lidhen me të

الحمد لله و صلى الله و سلم على نبينا محمد .أما بعد

VLERA E KURBANIT

Kurbani është bagëti e cila theret në ditët e caktuara që janë katër ditët e Kurban Bajramit, duke pasur për qëllim me të afrimin tek All-llahu - Subhaneh.

Kurbani është prej adhurimeve të mëdha, prej simboleve dhe dispozitave të mëdha fesë, me të cilin njeriu adhuron All-llahun, e madhëron Atë dhe shpreh me të mirënjohjen dhe falenderimin ndaj Tij - Subhaneh.

Thotë All-llahu i Lartësuar:

{فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَأُخِرْ}

{Falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban (vetëm për Të)}

Thotë All-llahu - Subhaneh:

{قُلْ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ}

{Thuaj: namazi im dhe kurban im, jeta ime dhe vdekja ime janë vetëm për All-llahun, Zotin e botërave}

Thotë All-llahu - Subhaneh:

{ذَلِكَ وَمَنْ يُعْظَمْ شَعَائِرَ اللَّهِ فَإِنَّهَا مِنْ تَقْوَى الْقُلُوبِ}

{Dhe kush madhëron simbolet (ritualet, dispozitat) e All-llahut, kjo është prej devotshmërisë së zemrave}

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

((...ما عَمِلَ آدَمِيُّ مِنْ عَمَلٍ يَوْمَ النَّحْرِ أَحَبَّ إِلَى اللَّهِ مِنْ إِهْرَاقِ الدَّمِ؛ إِنَّهَا لَتَأْتِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ بِقُرُونِهَا وَأَشْعَرُهَا وَأَظْلَافُهَا))

((Nuk vepron njeriu një punë në ditën e Kurbanit që është më e dashur tek All-llahu se sa derdhja e gjakut të kurbanit (dmth: bërja kurban).

Ai (kurbani) do të vije Ditën e Kijametit (do të sillet) me brirët, qimet dhe thundrat e tij))

[Termidhi, Ibn Maxheh. Albani e konsideron Sahih]

Dmth: do vendoset në peshore i plotë, bashkë me qimet, brirët dhe thundrat. Do të shpërblehet për të gjitha, edhe për qimet dhe brirët të cilat robi i ka hedhur si të pavlera.

[Mul-la Alij, në (Mirkat el mefetih)]

-- Fjala e tij: ((nuk vepron punë më të dashur tek All-llahu se sa kurbanit)) - Dmth: prej punëve të veçanta që bëhen ditën e Kurbanit, dhe jo se është më e mirë se çdo punë, sepse namazet farz janë më të mira dhe më të dashura se kurbanit.

Ky hadith tregon për vlerën e madhe që ka bërja e kurbanit.

Pra, duke qenë se bërja e kurbanit është puna më e dashur tek All-llahu prej të gjitha punëve të veçanta që bëhen në ditën e Kurbanit, kjo tregon për mirësinë dhe vlerën e madhe që ka bërja e kurbanit, prandaj nuk duhet neglizhuar, edhe pse në mendimin e shumicës së dijetarëve është i pëlqyer dhe jo obligim.

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

((إن أعظم الأيام عند الله تبارك و تعالى يوم النحر))

و في رواية: أفضل الأيام

((Dita më e madhe tek All-llahu është dita e Kurbanit))

Në një transmetim:

((Dita më e mirë tek All-llahu është dita e Kurbanit))

[Ebu Dawudi, Ahmedî. Albani thotë: hadith sahih]

Kjo ditë është më e mira dhe më e madhja, për shkak të adhurimeve të mëdha që bëhen në këtë ditë, ku ndër më të mëdhat dhe më të veçantat e kësaj dite është bërja e kurbanit, prej të cilit edhe e ka marr emrin - Dita e Kurbanit.

Ky hadith tregon për rëndësinë e madhe që ka bërja e kurbanit.

Ndërsa sa i përket disa haditheve, si për shembull hadithi që thotë:

((Për çdo qime ka sevap))

Apo hadithi:

((Në derdhjen e pikës së parë të gjakut i falen gjynahet))

Këto hadithe dhe të tjera janë të dobëta.

Në mendimin e shumë dijetarëve nuk ka hadith të saktë që tregon për vlerën e kurbanit.

Thotë Ibnul Arabij el Malikij, prej dijetarëve të mëdhenj Maliki:

" ليس في فضل الأضحية حديث صحيح "

"Nuk ka hadith të saktë në lidhje me vlerën e kurbanit."

I vetmi hadith i saktë që tregon për vlerën e kurbanit, në gjykimin e disa dijetarëve, prej tyre shejh Albani, është hadithi i lartpërmendur.

GJYKIMI I KURBANIT

Ka mospajtim ndërmjet dijetarëve në lidhje me gjykimin e kurbanit.

-- Shumica e dijetarëve thonë se bërja kurban është e pëlqyer, nuk është obligim (farz).

Ky është mendimi i Ebu Bekrit dhe Umerit -radijall-llahu anhumah-, siç transmeton Taberani nga Huthejfe bin Usejd [Imam Neueuiju thotë zinxhiri është i saktë, po kështu edhe shejh Albani].

Ky është mendimi i shumë tabi'inëve prej tyre: Seid bin Musejjeb, Alkameh, Ataa etj.

Ky është mendimi i Malikive dhe Shafive.

Ky është mendimi i shumë Hanbelive.

Ky është mendimi i Bin Bazit, Ibn Utthejmin, Feuzanit, AbdulMuhsin el Abbad etj.

Thotë Imam Neueuiju:

"Shumica e dijetarëve thonë se bërja kurban është sunnet, (nuk është obligim). Nëse nuk bën kurban, nuk ka gjynah."

[Sherh Sahih Muslim. 13/110]

Shejh AbdulMuhsin el Abbad (All-llahu e ruajt) ka thënë:

"Bërja kurban nuk është obligim, por është e pëlqyer, duke u bazuar në hadithin:

((إِذَا دَخَلَ الْعَشْرُ ذُو الْحِجَّةِ وَرَأَى أَحَدُكُمْ أَنْ يَضْحَى...))

((Kur të hyje dhjetëditëshi i Dhul Hixhxes dhe ndonjëri prej jush dëshiron të bëjë kurban...))

[Muslimi]

Thotë shejhu:

"قوله ((يدل على أنه ما فيه وجوب؛ لأنه لو كان واجبا ما فيه حاجة لذكر الإرادة

"Fjala e Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem: ((Dëshiron)) tregon se nuk është detyrë, sepse sikur të ishte detyrë, nuk do ishte e nevojshme përmendja e dëshirës."

Dmth: nëse do ishte obligim, nuk do lihej në dëshirën e robit, ku thotë: *((dhe dëshiron))*

-- Ndërsa disa dijetarë tjerë thonë se bërja kurban është obligim për atë që ka mundësi.

Ky është mendimi i Rabiah Er-Ra'j, tabi'in, shejhu i Imam Malik (v 136.h).

Ky është mendimi i Lejth bin Sead, prej tabi tabi'inëve, dijetar i madh, bashkëkohës i Imam Malik.

Ky është mendimi i Ebu Hanifes.

Ky është mendimi i Ibn Tejmijes.

Këtë mendim ka edhe shejh Albani (All-llahu i mëshiroftë të gjithë).

Shejh Albani (All-llahu e mëshiroftë) ka thënë:

"الذي يستطيع أن يضحي فقد وجبت عليه الأضحية"

"Ai që ka mundësi të bëjë kurban, e ka obligim të bëjë kurban."

[Silsiletul Hude uen-Nur 1029. alathar net]

Këta dijetarë bazohen në disa argumente, prej tyre:

1) All-llahu -Subhanehu ue Teaala- ka thënë:

{فَضْلٌ لِرَبِّكَ وَأَنْحُرْ}

{Falu vetëm për Zotin tënd dhe ther kurban (vetëm për Të)}

2) Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

((من وجد سعةً [و في رواية: مالا] و لم يُضَحَّ فلا يُقَرَّبَنَّ مصلانا))

((Ai i cili ka mundësi (në një transmetim: ka pasuri) dhe nuk bën kurban, mos t'i afrohet vendfaljes tonë))

[Ahmedi, Albani e konsideron Sahih]

Thonë këta dijetarë: *"Fjala e Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem: ((Mos t'i afrohet vendfaljes tonë)) tregon se bërja kurban është obligim, sepse kjo fjalë (formë shprehje kaq qortuese) nuk thuhet përveçse për atë që len diçka që është obligim.*

Sikur të ishte me dëshirë, siç mendon shumica, nuk do fliste me këtë fjalë qortuese të fortë."

3) Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

((من ذَبَحَ قَبْلَ أَنْ يَصْلِيَ فَلْيُعَذَّ مَكَانَهَا أُخْرَى و من لم يذبح فَلْيَذْبَحْ))

((Kush e ka ther kurbanin para se t'a fale Bajramin, le të ther një tjetër në vend tij. Dhe kush nuk ka ther (kurban), le të ther))

[Buhariu dhe Muslimi]

Thonë këta dijetarë: *"Urdhëri i Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem që të ther kurban tjetër në vend të atij që e theri para namazit, tregon se është obligim. Sepse sikur të ishte me dëshirë nuk do e urdhëronte të bënte kurban tjetër, ngase kjo është shpenzim pasurie."*

Ndërsa sa i përket argumentimit të atyre që e konsiderojnë bërjen kurban të pëlqyer me fjalën e Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem: ((dhe dëshiron të bëjë kurban)), fjala ((dëshiron)) do të thotë që është me dëshirë.. **ky argumentim nuk është i saktë, nuk qëndron**, sepse kemi shumë raste ku përmendet dëshira për një gjë dhe ajo gjë është obligim.

Thotë All-llahu - Subhaneh:

{وَمَنْ أَرَادَ الْآخِرَةَ وَسَعَى لَهَا سَعْيَهَا}

{Dhe kush dëshiron Ahiretin}

A mund të thuhet që kërkitimi i Ahiretit është me dëshirë?! Është i pëlqyer?!

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

((مَنْ رَأَى الْحَجَّ فَلْيَتَعَجَّلْ)).

((Kush dëshiron të bëjë haxhin, le të nxitoje))

[Ebu Dawudi, etj. Albani e konsideron Hasen]

A mund të thuhet që haxhi është me dëshirë?!

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem këtu ka patur për qëllim haxhin farz.

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

((إِذَا رَأَى أَحَدُكُمْ أَنْ يَأْتِيَ الْجُمُعَةَ فَلْيَغْتَسِلْ))

((Kur dikush dëshiron të shkojë në namazin e xhumasë, le të lahet -të marre gusël-))

[Buhariu, Muslimi]

A mund të themi se namazi i xhumasë është me dëshirë, është i pëlqyer?

Jo. Namazi i xhumasë është obligim.

Prandaj, fjala ((dhe dëshiron të bëjë kurban)) nuk do të thotë që është me dëshirë.

Une anoj te ajo që të qenurit obligim (për atë që i ka mundësitë, duke mos lënë mangut nevojat familjare) është më afër se sa të qenurit i pëlqyer.

BËRJA KURBAN ME NJË BAGËTI E CILA SHITET ME KILE MISHI PASI TË THERET

Prej kushteve të kurbanit është që bagëtia të jetë pronë e atij që dëshiron të bëjë kurban më të.

Për këtë ka unanimitet.

Kjo lloj forme kurban: *“Që të zgjedhë një bagëti dhe pastaj t’a ther, dhe pasi t’a ther, t’a peshoje se sa kile është, dhe mbi bazën e kileve caktohet se sa i bën haku bagëtisë dhe sa do paguaj, kjo lloj forme, nuk konsiderohet kurban pa fije dyshimi.*

Kjo sepse, prej kushteve të kurbanit është që bagëtia të jetë pronë e atij që bën kurbanin, dhe për këtë ka unanimitet të plotë, jo vetëm te dijetarët, por te të gjithë njerëzit. Të gjithë e dimë se kurban nuk bëhet me bagëtinë e huaj.”

Në rastin konkret personi nuk e posedon akoma këtë bagëti, sepse akoma nuk e ka blerë, akoma nuk është realizuar blerja.

Që të realizohet blerja, dhe bagëtia të konsiderohet pronë e atij që don të bëjë kurban, duhet që shitblerja të jetë e saktë (e vlefshme).

Që shitblerja të jetë e saktë (e vlefshme) duhet të plotësohen kushtet e saj.

Prej tyre është njohja e çmimit dhe dakordësia.

Thotë Ibnul Mundhir në [El Ixhma] dhe Ibnul Kattan në [El Iknaa] - All-llahu i mëshiroftë:

قال ابن المنذر في الإجماع، وابن القطان في الإقناع "وأجمعوا على أن من باع سلعة بثمن مجهول غير معلوم، ولا مسمى، ولا عينا قائما، أن البيع فاسد"

“Dijetarët kanë rënë dakord se kush shet një mall me një çmim të panjohur, të papërcaktuar, atëherë shitblerja është e pavlefshme.”

Ibn Hazmi (All-llahu e mëshiroftë) ka thënë:

: قال ابن حزم رحمه الله في "المحلى" 512/ 7

"وَلَا يَصِحُّ الْبَيْعُ بِغَيْرِ ثَمَنِ مُسَمًّى"

"Nuk është e vlefshme shitblerja pa një çmim të caktuar.”

[El Muhal-la. 7/512]

Ibn Uttejmini (All-llahu e mëshiroftë) ka thënë:

: وقال ابن عثيمين رحمه الله

" جهالة الثمن تؤدي إلى بطلان البيع ؛ لأن من شروط البيع العلم بالثمن "

انتهى من "الشرح الممتع" 8/233)

"Mosnjohja e çmimit çon në pavlefshmërinë e shitjeblerjes (dmth: konsiderohet e pavlefshme), sepse prej kushteve të shitblerjes është që çmimi të jetë i ditur."

[Esh Sherh el Mumti. 8/233]

Pra, që shitblerja të konsiderohet e vlefshme, dhe produkti (malli) të kalojë në pronësi të blerësit duhet që produktit (mallit) t'i dihet çmimi, dhe pas kësaj blerësi të bëjë dakord.

Në rastin konkret çmimi se sa do paguaj nuk dihet. Dihet thjeshtë se si do shitet - dmth: dihet se do shitet me kile, dhe kilja është kaç, ama çmimi përfundimtar nuk dihet derisa të theret.

Kur të theret dhe të peshohet, atëherë dihet çmimi përfundimtar, pastaj bëjë dakord për kilet dhe i jep paratë.

Një argument i thjeshtë që e vërteton këtë është se nëse ndodh që bagëtia ngordh para se me e ther, për shembull: i ikën nga duart dhe bëjë në kanal uji dhe mbytet.. kush dëmtohet dhe kush e paguan?

-- Nëse themi: shitësi, atëherë bëhet e qartë se bagëtia nuk ka qenë e atij që donte të bënte me të kurban.

-- Nëse themi: e paguan ai që donte të bëjë me të kurban, atëherë sa do të paguaje ai? Bagëtia tashmë është e ngordhur, as nuk theret, as nuk peshohet.

Më këtë arrijmë të kuptojmë se ndërmjet shitësit dhe blerësit nuk ka ndodhur shitblerje, dhe si rezultat bagëtia nuk ka kaluar në pronësi të personit që donte të bëjë kurban më të.

Dhe me këtë bëhet e qartë se bagëtia nuk është e atij që don të bëjë kurban me të.

Thënë ndryshe nuk është pronë e tij.

Dhe përderisa nuk është pronë e tij, me pronën e huaj nuk bëhet kurban.

NJË KURBAN MJAFTON PËR GJITHË FAMILJEN

Nëse kryetari i familjes, ose kujdestari i familjes bën kurban për veten dhe familjen e tij, kurban i tij mjafton për të gjithë anëtarët e familjes.

عن عطاء بن يَسَارٍ قال :سَأَلْتُ أَبَا أَيُّوبَ الْأَنْصَارِيَّ كَيْفَ كَانَتْ الصَّحَابَا عَلَى عَهْدِ رَسُولِ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَقَالَ : كَانَ الرَّجُلُ (يَضْحِكُ بِالشَّاعَةِ عَنْهُ وَعَنْ أَهْلِ بَيْتِهِ فَيَأْكُلُونَ وَيُطْعَمُونَ حَتَّى تَبَاهِيَ النَّاسُ فَصَارَتْ كَمَا تَرَى .

Ataa bin Jaasir thotë: E pyeta Ebu Ejub el-Ensari:

"Si bëheshin kurbanet në kohën e të Dërguarit të All-llahut?"

Ai tha: *"Njeriu bënte kurban një dele për veten dhe për familjen e tij. Hanin prej saj dhe u jepnin të tjerëve, derisa njerëzit filluan të mburren, e pastaj u bë siç po e sheh."*

[Termidhi, Ibn Maxheh]

Ibn Uttejmini (All-llahu e mëshiroftë) ka thënë:

إذا كانوا عائلة في بيت واحد كفتهم أضحية واحدة؛ لأن النبي صلى الله عليه وسلم ضحى بأضحية واحدة عنه وعن أهل بيته، وكان نسأؤه اللاتي معه تسع نساء، ومع ذلك ضحى عنهن بأضحية واحدة، أما إذا كان هؤلاء الأبناء كل واحد في بيت منفرد عن الآخر، فإن على كل واحد منهم أضحية، ولا تطفى أضحية الوالد عنهم.

"Nëse janë një familje në një shtëpi, atyre u mjafton një kurban i vetëm, sepse Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka bërë një kurban të vetëm, për veten dhe familjen e tij. Gratë e tij ishin nëntë, megjithatë ai bëri një kurban për të gjithë ato."

[Audio]

Ibn Uttejmini (All-llahu e mëshiroftë) ka thënë:

البيت الواحد يضحي القيم على البيت، ان كان الأب أو الزوج أو الأخ الأكبر. المهم القيم على البيت هو الذي يضحي وينوي عنه و عنهم جميعا.

من الذي يعتبر الراعي لهذا البيت؟

أكبر الاولاد. إذا هو الذي يضحي، و الأم تدخل في أضحية الولد.

"Për një shtëpi mjafton që kurbanin ta bëjë përgjegjësi (kujdestari, i pari) i shtëpisë, qoftë babai, burri apo vëllai i madh. Me rëndësi është që kujdestari dhe përgjegjësi i familjes, ai bën kurban për veten dhe për të gjithë familjen e tij."

Pyeti shejhu: cili është kujdestari i shtëpisë?

I tha: Djali i madh.

Tha shejhu: atëherë ai e bën kurbanin.

Ndërsa nëna hyn në kurbanin e tij (dmth: nuk ka nevojë të bëjë nëna kurban. Nëna hyn në kurbanin e djalit që është kujdestari i familjes)."

[Lika El Beeb el meftuuh. Audio]

■ NËSE JETOJNË DY FAMILJE APO MË SHUMË NË NJË SHËTËPI, MJAFTON NJË KURBAN PËR TË GJITHË

Thotë Ibn Uttejmini:

"يجوز أن يقتصر أهل بيت واحد و لو كانوا عائلتين على أضحية واحدة"

"Lejohet që në një shtëpi, edhe nëse janë dy familje që jetojnë në të, lejohet të mjaftohen me një kurban të vetëm."

[Nurun alad Derb. Audio]

■ NËSE KA DISA GRA, DHE SECILA ËSHTË NË SHËTËPINË E VET, MJAFTON NJË KURBAN PËR TË GJITHË

Personi i cili ka dy gra, apo tre, secila në shtëpinë e vet, një kurban mjafton për të gjithë, edhe pse janë në shtëpi të ndara, ngase të gjitha janë familja e tij.

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka patur nëntë gra, secila në shtëpinë e vet, dhe Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka bërë vetëm një kurban për të gjithë.

Shejh Abbadi (All-llahu e ruajt) thotë:

"Mjafton një kurban për të gjitha."

[Sherh Sunen et-Termidhi. Kitabul Edahi 173. alathar net. Audio]

Po kështu thotë edhe Ibn Uttejmini (All-llahu e mëshiroftë), e të tjerë.

■ NËSE JETOJNË DY VËLLEZËR NË NJË SHTËPI, SECILI NË LLOGARINË E VET, POR HANË BASHKARISHT, NJË KURBAN MJAFTON

Nëse jetojnë në një shtëpi dy vëllezër secili në llogarinë e vet, pëlqehet (sipas disa dijetarëve) që secili të bëjë kurban më vete.

Është pyetur shejh Bin Bazi në lidhje me kurbanin e dy vëllezërve që banojnë në një shtëpi, ndërkohë ushqimin dhe pijen e tyre e kanë të përbashkët, por rrogën secili e mban vetë (dmth: nuk e kanë parane të përbashkët).

: سئل الشيخ ابن باز عن أضحية: أخوين ساكنين في بيت واحد وأكلهما وشربهما واحد، ولكن رواتب كل منهما على حدة. فأجاب بقوله: إن كان الواقع كما ذكر فالمشروع أن يضحي كل واحد منهما عن نفسه وعائلته بأضحية واحدة لكونهما عائلتين.. إلخ

Shejhu u përgjigj duke thënë:

"Nëse realiteti është ashtu siç u përmend, atëherë është e pëlqyer që secili prej tyre të bëjë një kurban për veten dhe familjen e tij, sepse konsiderohen dy familje..."

Disa dijetarë thonë:

"Mjafton një kurban për të dy (familjet), por, duhet t'a bëjnë me radhë. Një vit njëri, një vit tjetri."

U pyet Ibn Uttejmini në lidhje me dy vëllezër të cilët jetojnë bashkë, por secili ka llogarinë (rrogën) e vet, a mjafton një kurban për të dy?

يكفيهم أضحية واحدة يتناولونها، يعني هذا العام يضحي زيد و العام الثاني يضحي عمرو ، ..على الجميع ...و لا يشتركون في قيمة الأضحية.

U përgjigj shejhu:

"Mjafton për ta një kurban i vetëm, por t'a bëjnë me radhë. Pra, këtë vit bën kurban njëri, vitin e ardhshëm tjetri... për të gjithë..."

Por, jo të marrin pjesë bashkarisht në pagesën e kurbanit."

[Pyetje nëpërmjet telefonit. ALUthaymeen. Audio]

U pyet Ibn Uttejmini All-llahu e mëshiroftë:

: سئل الشيخ ابن عثيمين رحمه الله " :هل تجوز أضحية واحدة لأخوين شقيقين في بيت واحد مع أولادهم أكلهم وشربهم واحد؟ فأجاب :نعم يجوز ذلك .يجوز أن يقتصر أهل البيت الواحد ولو كانوا عائلتين على أضحية واحدة

A lejohet një kurban i vetëm për dy vëllezër që jetojnë në një shtëpi, bashkë me fëmijët e tyre, ndërkohë ushqimin dhe pijen e kanë të përbashkët?

U përgjigj shejhu:

"Po, kjo lejohet. Lejohet që banorët e një shtëpie, edhe nëse janë dy familje, të mjaftohen me një kurban të vetëm."

[Fetawa Nurun aled Derb]

■ NËSE JETOJNË TË NDARË SECILI NË SHITËPINË E TIJ, ATËHERË SECILI BËN KURBAN PËR VETEN E TIJ DHE FAMILJEN E TIJ

Thotë Ibn Uthejmini:

"أما إذا كان هؤلاء الأبناء كل واحد في بيت منفرد عن الآخر، فإن على كل واحد منهم أضحية، ولا تكفي أضحية الوالد عنهم"

"Ndërsa nëse këta djem jetojnë secili në shtëpi të ndarë nga tjetri, kurban i babit nuk mjafton për ta.

Por, secili prej tyre duhet të bëjë kurban më vete."

■ NËSE JETOJNË NË NJË SHITËPI, DHE KANË NJË TË PARË (KUJDESTAR), HANË BASHKARISHT, POR LLOGARITË I KANË TË NDARA

Nëse në një shtëpi jetojnë dy familje, dhe llogaritë i kanë të ndara, por të gjithë janë nën kujdestarinë e babait, apo të vëllaut të madh, dhe hanë bashkarisht, në këtë rast mjafton një kurban për të gjithë (insha All-llahu), sepse të gjithë konsiderohen një familje, përse kohë kanë një të parë, dhe janë nën kujdestarinë e tij. Edhe pse i kanë llogaritë e ndara.

● NËSE JETOJNË NË NJË SHITËPI, POR SECILI KA DHOMËN E TIJ ME FAMILJEN E TIJ, DHE SECILI GATUAN NË VETE, SECILI BËN KURBAN

Këta konsiderohet si të jenë të ndarë, kështu që secili (nëse kanë mundësi) duhet të bëjnë kurban më vete.

All-llahu e di më së miri

● NËSE KUJDESTARI JETON NË NJË SHITËPI TJETËR, MJAFTON NJË KURBAN PËR TË GJITHË

Nëse një person jeton me familjen e tij, ndërsa prindërit e tij, vëllezërit dhe motrat e tij jetojnë në tjetër shtëpi, ndërkohë ai shpenzon, dhe kujdeset për ta, në këtë rast mjafton një kurban që e pret ai, edhe për veten dhe për ata që i ka nën kujdestari, edhe pse nuk jeton me ata.

U pyet shejh Feuzani në lidhje me këte rast, dhe tha:

"Mjafton një kurban që e bën për veten, dhe për ata që i ka nën kujdestari."

Kjo është e saktë, sepse përderisa shpenzon për ta dhe i ka nën kujdestarinë e tij, atëherë këta janë familja e tij, edhe pse jeton larg tyre.

■ NËSE KRYETARI I FAMILJES NUK KA MUNDËSI PËR TË BËRË KURBAN, LEJOHET QË TË BËJE KURBAN GRUAJA, OSE NDONJË ANËTAR TJETËR I FAMILJES

Shejh Albani (All-llahu e mëshiroftë) ka thënë:

المهم أن هذا البيت يخرج منه أضحية ، سواء من كان الذي أخرج الأضحية هو الأب أو الوالد ، ثم سواء كان الولد هو الكبير أو الصغير المهم على كل أهل بيت في كل عام أضحية ،

"E rëndësishme është që në shtëpi të bëhet kurban, (dmth: familja të bëje kurban), qoftë babai ai që e bën, apo fëmija, i madhi ose i vogli. E rëndësishme është që çdo shtëpi (çdo familje) të bëje kurban në çdo vit."
[Silsiletul hude uen-nur 406. alathar net]

Dmth: nëse kryetari i familjes nuk ka mundësi, dhe dikush nga anëtarët ka mundësi, lejohet që të bëje ai kurban, për veten dhe familjen. Madje në mendimin e disa dijetarëve është obligim.

Disa thonë se e mira në këtë rast është që të ndihmohet kryetari i familjes me para, që t'a bleje ai.

Disa thonë se duhet të marrin pjesë bashkarisht në vlerën (pagesën) e Kurbanit.

Ndoshta më e përafërta dhe më larg dyshimit në këtë rast është që të ndihmohet i pari i shtëpisë nëse nuk e ka shumën e mjaftueshme (me nijetin për t'a ndihmuar, jo për të qenë ortak në blerjen e kurbanit), ashtu që t'a blejë ai kurbanin, dhe t'a bëjë ai për veten dhe familjen.

NËSE NJË GRUP NJERËZISH JETOJNË BASHKARISHT DHE SHPENZIMET I KANË TË PËRBASHKËTA (SIPAS DISA DIJETARËVE) LEJOHET TË BËJNË NJË KURBAN PËR TË GJITHË

Shejh Salih Ali Shejh (All-llahu e ruajt) thotë:

إذا كان جماعة يسكنون مكانا واحدا و أكلهم واحد، - يعني: نفقتهم واحدة- يشتركون في الأكل ، و نفقتهم على هذا البيت واحدة، قال بعض أهل العلم: لهم حكم الأسرة الواحدة، و يجوز أن يشتركوا في أضحية، يُضَحِّيها واحد منهم عنه و عن من في هذا....الدار؛ لاشتراكهم في النفقة

"Lken إذا كان هذا يستقل بنفقة و هذا يستقل بنفقة و لو كانت قليلة، فإن هذا لا يجزىء؛ لأن الأصل عدم الاشتراك

"Nëse një grup njerëzish banojnë në një shtëpi, dhe ushqimi i tyre është i përbashkët (domethënë shpenzimet e tyre janë të përbashkëta), kanë bashkë dhe shpenzimet e kësaj shtëpie janë të përbashkëta, (në këtë rast) disa dijetarë kanë thënë se ata marrin gjykimin e një familjeje të vetme, dhe lejohet që të marrin pjesë në një kurban të vetëm, të cilin e bën njëri prej tyre për veten dhe për të gjithë banorët e asaj shtëpie, kjo për shkak të përbashkimit në shpenzime.

Ama, nëse secili ka shpenzimet e veta të ndara, edhe nëse ndarja është e vogël, kurbanin nuk është i vlefshëm, sepse parimi bazë është se nuk lejohet marrja pjesë e disa personave në vlerën e një kurbanit."
[حكم الاشتراك في ثمن الأضحية . Audio]

Shejh Salih anon te ky mendim.

Ky mendim qëndron nëse ata kanë një të parë tek i cili i dorëzojnë paratë. Dhe paraja që dorëzojnë çdo muaj ka tepriçë për kurbanin, dhe përgjegjësi bën me to kurban.

Ama nëse paratë që dorëzojnë janë të mjaftueshme vetëm për shpenzimet e shtëpisë, dhe për kurban duhet me shtu secili para ekstra, në këtë rast më e përafërta është që nuk bën.

Në mendimin e atyre që thonë se familja bën që të marrin pjesë në vlerën (pagesën) e kurbanit, bën për këtë grup të cilët janë si një familje.

Duke u bazuar në hadithin:

((على كل أهل بيت في كل عام أضحية))

((Çdo familje në çdo vit duhet të bëjnë kurban))

[Ahmedi, etj Albani e konsideron Hasen]

Por, unë nuk jam shumë i bindur te kjo.

All-llahu e di më së miri.

A BËN TË MARRIN PJESË NË PAGESËN E KURBANIT EDHE ANËTARË TJERË, KRAHAS KRYETARIT TË FAMILJES, QOFTË AJO GRUAJA, APO FËMIJËT?

Ibn Utheimi rahimehull-llah ka thënë:

"اشترك الإنسان و زوجته في قيمة شاة، فإن هذا لا يصح ؛ لأنه لا يشترك اثنان في القيمة في شاة واحدة"

"Pjesëmarrja e një personi dhe e gruas së tij në pagesën e vlerës së një deleje (për kurban) nuk është e saktë (nuk është e vlefshme), sepse dy persona nuk bëhen ortakë në vlerën e një deleje të vetme."

[Mexhmu Fetewa Ibn Utheimi. 25/46]

Edhe shejh Abdulaziz Ali Shejh (All-llahu e mëshiroftë) thotë se kjo gjë nuk është e vlefshme.

Disa dijetarë thonë: *"Nëse kryetari i familjes nuk i ka paratë e mjaftueshme për të bërë kurban dhe merr pjesë edhe gruaja, apo ndonjë fëmijë i tij, lejohet. Është e vlefshme."*

Duke u bazuar në atë se kurbanit është detyrë për gjithë familjen.

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

((على كل أهل بيت في كل عام أضحية))

((Çdo familje, për çdo vit duhet të bëjë kurban))

[Ahmedi etj. Albani e konsideron Hasen]

Kështu që nëse nuk ka mundësi kryetari i familjes, atëherë lejohet të marre pjesë në blerjen e kurbanit edhe ndonjë anëtar tjetër, sepse (sipas tyre) kërkesa për blerjen e kurbanit bie mbi të gjithë.

Unë anoj te ajo që paratë duhet të jenë të atij që bën kurbanin, duke u bazuar te hadithi i Ebu Ejub ku thotë:

((يضحي عنه وعن أهل بيته))

((Bënte kurban për veten dhe familjen e tij))

Nëse paraja është e përbashkët, kurbanin nuk është i asnjërit, por është i të gjithëve, kështu që nuk mund të realizohet ajo çfarë thotë hadithi ((Bënte kurban për veten dhe familjen e tij)), sepse nuk është e tij, por është e përbashkët.

Ndoshta hadithi ((Çdo familje në çdo vit duhet të bëjë kurban)), mund të jetë argument që nëse nuk e bën dot kryetari, mund t'a bëjë gruaja për veten dhe familjen, nëse ajo ka mundësi, ose ndonjë anëtar tjetër. E rëndësishme është që familja të bëjnë kurban.

Ama që të marrin pjesë në vlerën (pagesën) e kurbanit, nuk është shumë bindëse. All-llahu e di më së miri.

NËSE KRYETARI I FAMILJES BËN KURBAN, NUK ËSHTË PREJ SUNNETIT QË DIKUSH NGA FAMILJA TË BËJE KURBAN TJETËR

Nëse kryetari i familjes, ose ndonjë tjetër nga familja bën kurban për veten dhe familjen (sipas mendimit të dijetarëve që e lejojnë që edhe një anëtar i familjes të bëjë kurban për familjen), nuk është prej sunnetit që dikush nga familja të bëjë kurban tjetër.

Është pyetur Ibn Uthejmini (All-llahu e mëshiroftë):

هل من الأفضل أن تضحي المرأة عن نفسها مع أن زوجها يضحي عنه وعن أهل بيته وهي منهم ؟
فأجاب ابن العثيمين رحمه الله
...إن هذا غير مشروع وخلاف السنة وأنه يكفي للبيت أضحية واحدة تشمل أهل البيت الواحد كلهم

ويقول رحمه الله
ف نجد أحياناً الزوج يضحي عنه وعن أهل بيته، فتأتي زوجته وتقول أريد أن أضحي أنا أيضاً
وتأتي أخته، وتقول أريد أن أضحي
ثم تأتي البنت وتقول أريد أن أضحي
فتجتمع في البيت الواحد ضحايا متعددة
وهذا خلاف ما عليه السلف الصالح

فإن أكرم الخلق محمد صلى الله عليه وسلم لم يضح إلا بواحدة عنه وعن أهل بيته، ومعلوم أن له تسع نساء يعني تسع بيوت ومع ذلك
ماضى إلا بواحدة عنه وعن أهل بيته
وضحى بأخرى عن أمته صلى الله عليه وسلم
وكان الصحابة يضحي الرجل منهم بالشاة الواحدة عنه وعن أهل بيته.

فما عليه كثير من الناس اليوم فهو إسراف ونقول لهؤلاء الذين يضحون بهذه الضحايا
"إذا كان عندكم فضل مال فهناك أناس محتاجون لهذا المال من المسلمين"

لقاء باب المفتوح ٩٢/٣ (فتاوى الشيخ

"A është më mirë që gruaja të bëjë kurban për veten e saj, ndërkohë që burri i saj bën kurban për veten dhe familjen e tij, dhe ajo është prej tyre?"

Shejhu u përgjigj:

"Kjo nuk është e ligjshme dhe është në kundërshtim me Sunnetin. Mjafton një kurban për një shtëpi, që i përfshin të gjithë anëtarët e asaj shtëpie."

Thotë:

“Ndonjëherë ndodh që burri bën kurban për veten dhe familjen e tij, pastaj vjen gruaja dhe thotë: ‘Dua të bëj edhe unë kurban’. Pastaj vjen motra dhe thotë: ‘Dua të bëj edhe unë kurban’. Pastaj vjen vajza dhe thotë: ‘Dua të bëj edhe unë kurban’. Dhe kështu mblidhen në një shtëpi shumë kurbane. Kjo është në kundërshtim me atë që kanë qenë selefët e mirë.

Krijesa më e nderuar Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem nuk ka bërë, përveçse një kurban, për veten dhe familjen e tij. Dihet se ai kishte nëntë gra, domethënë nëntë shtëpi, megjithatë ka bërë vetëm një kurban për veten dhe familjen e tij. Ndërsa një tjetër e bëri për umetin e tij sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem.

Edhe sahabët, bënin një dele kurban, për veten dhe familjen.

Ndërsa ajo që bëjnë shumë njerëz sot është shpërdorim.

Dhe u themi këtyre që bëjnë shumë kurbane: nëse keni tepricë pasurie, ka muslimanë nevojtarë që kanë më shumë nevojë për këtë pasuri (dmth: t’i ndihmosh me para, apo gjëra tjera për të cilat kanë nevojë).”

[Likaa el-Baab el-Meftuuh” (92/3)]

[Fetwatë e Shejh Ibn Uthejmin” (25/175)]

Shumë dijetarë e lejojnë të bësh më shumë se një kurban.

Shejh Bin Bazi thotë se lejohet të bësh më shumë se një kurban.

Unë anoj te mendimi i atyre që thonë se kjo gjë nuk është prej sunnetit, sepse nuk e ka bërë Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem dhe shokët e tij.

Thotë Ebu Ejub el-Ensari:

كَانَ الرَّجُلُ يُصَيِّ بِالسَّائَةِ عَنْهُ وَعَنْ أَهْلِ بَيْتِهِ، فَيَأْكُلُونَ وَيُطْعَمُونَ. صححه الألباني في صحيح الترمذي.

“Njeriu (në kohën e Profetit sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem) bënte kurban një dele për veten dhe për familjen e tij. Ata hanin prej saj dhe u jepnin të tjerëve.”

[Termidhi. Albani thotë hadith Sahih]

PËLQEHET QË PERSONI T’A THER VET KURBANIN E TIJ. E NËSE NUK E THER DOT, TË PREZANTOJE NË THERJEN E TIJ

Është shumë e pëlqyer që t’a therësh kurbanin vetë, sepse vet therja e Kurbanit është adhurim i madh.

Thotë Ibn Uthejmini:

فإن الذبح من أكبر العبادات

“Therja e Kurbanit është prej adhurimeve më të mëdha.”

Kur e ther vetë zbaton një tjetër adhurim të madh që është përmendja e emrit të All-llahut kur e ther kurbanin.

Nëse nuk e ther dot vetë, atëherë të prezantosh kur të theret kurbanin.

Thotë Ibn Uttejmini:

فإن لم يحسن قال العلماء: يحضر ذبحها

"Nëse nuk e ther dot, thonë dijetarët: atëherë të prezantoje në therjen e kurbanit."

Duhet të prezantosh te therja e Kurbanit tënd, duhet të angazhohesh me këtë adhurim.

Duhet të të preokupoje ky adhurim.

Preokupimi, dhe angazhimi me këtë adhurim tregon përkushtim ndaj All-llahut dhe devotshmëri ndaj tij.

Dhe pikërisht ky është thelbi i adhurimeve.

Thotë All-llahu تعالى:

{لن ينال الله لحومها ولا دماؤها ولكن يناله التقوى منكم}

Kuptimi:

{Te All-llahu nuk arrin mishi i tyre dhe as gjaku i tyre, porse te Ai arrin devotshmëria juaj}

Ibn Abbasi رضي الله عنهما thotë:

Kuptimi: "Ngjitet te Ai devotshmëria."

Dmth: ajo që ngjitet, ngrihet te Ai dhe arrin te Ai dhe shpërblen për të është devotshmëria.

[Kurtubiu në tefsirin e tij]

Kjo që bëjnë një pjesë e madhe duke ia lënë tjetrit të merret me kurbanin e tij, dhe vetëm pasi të mbarojë shkon për të marr mishin, kjo tregon dembelizëm ndaj këtij adhurimi.

Dhe kjo është dobësi në këtë adhurim, dhe si rezultat edhe shpërblimi është i dobët, i mangët.

PRERJA E KURBANIT

RREGULLA DHE ÇESHTJE QË LIDHEN ME PRERJEN E KURBANIT

● Pëlqehet të kthehet bagëtia nga kibla.

Thotë Bin Bazi:

والسنة توجيها إلى القبلة

"Prej sunnetit është t'a kthesh nga kibla."

[Albani, Ibn Uttejmin, Lexhnja]

● Thënia BISMIL-LAH kur t'a therim.

Përmendja e emrit të All-llahut është kusht.

Nëse nuk thuhet me qëllim, nuk pranohet kurban.

Nëse harron të thotë Bismil-lah, kurban është i saktë.
[Shumica]

- **Thënia ALL-LLAHU EKBER.**

Pëlqehet pas fjalës Bismil-lah të thotë: ALL-LLAHU EKBER.

- **Pastaj pëlqehet të thotë:**

ALL-LLAHUMME HADHA MINKE UE LEK.

“O All-llah! Ky (kurban) është prej Teje dhe për Ty.”

(Dmth: është rizk prej Teje, dhe e bëj sinqerisht për Ty)

- **Pastaj pëlqehet të thotë:**

HADHA ANNI.

“Ky (kurban) është nga unë.”

-- Nëse është kryetar familje thotë:

HADHA ANNI UE AN EHLE BEJTI

“Ky (kurban) është nga unë dhe nga njerëzit e shtëpisë time.”

- **Pastaj pëlqehet të thotë:**

TEKABEL MINNI

“Pranoje prej meje.”

-- Nëse është kryetar familje thotë:

TEKABEL MINNI UE MIN EHLE BEJTI

“Pranoje prej meje dhe prej njerëzve të shtëpisë sime.”

- **Pastaj e ther.**

- **Thika duhet të jetë e mprehtë.**

DISA RREGULLA NË LIDHJE ME ATË QË E THER KURBANIN

- **Pëlqehet t’a mpreh thikën.** [Shumica e dijetarëve]

--- Disa dijetarë e konsiderojnë obligim që thika të jetë e mprehtë. Që do të thotë se nëse nuk është e mprehtë ka bërë haram, por, kurban është i saktë.

قال [فتح ذي الجلال والإكرام 6/64 : [من فوائد الحديث : وجوب حد الشفرة لقوله (وليحد أحدكم شفرته)
و إذا قلنا بوجوب حد الشفرة صار الذبح بشفرة ليست حادة حراما

● **Të mos e mpreh thikën në sy të bagëtisë tjetër.**

Është e papëlqyer (Mekruh) t'a ther bagëtinë në sy të bagëtisë tjetër.

● **Është kusht që ai i cili e ther kurbanin të jetë musliman, besimtar.**

Ose jehudi apo i krishterë, besimtarë në fenë e tyre.

[Unanimitet i Dijetarëve]

--- Ai që i thotë vetës jehudi, apo i krishterë dhe nuk beson në fenë tij, nuk pranohet therja e tij.

● **Disa mendojnë se mjafton që vetëm pronari i kurbanit të thotë Bismil-lah, që do të thotë se nëse kasapi nuk thotë Bismil-lah, s'ka problem.**

Shejh Ibn Uthejmini thotë:

"Kjo nuk është e saktë. Kasapi (ai që e pret), ai thotë Bismil-lah. Sepse therja është veprim i kasapit, dhe ai do e përmende emrin e All-llahut për veprimin e tij."

و الذي يسمى الذابح لأنه فعله، فهو يسمى على فعله.

● **A duhet që jehudiu dhe i krishteri besimtar, që ther kurbanin e muslimanit të thotë Bismil-lah, dhe nëse nuk e thotë a është e pranuar therja?**

Ka mospajtim të madh në lidhje me këtë.

-- Një pjesë thonë: *"Është kusht që t'a përmende emrin e All-llahut qoftë duke thënë: NË EMËR TË ZOTIT. Nëse nuk e përmend, nuk lejohet."*

--- Disa thonë: *"Nuk është kusht. Edhe nëse nuk e përmend, pranohet."*

--- Disa thonë: *"Nëse e përmend emrin e jesusit kur e ther, nuk lejohet mishi."*

--- Disa tjerë thonë: *"Lejohet."*

Mospajtimi është shumë i madh.

Ajo te e cila anoj është: "Nëse nuk e përmend emrin e Zotit, dhe asnjë emër tjetër, therja konsiderohet e saktë, dhe mishi është hallall."

[Siç thotë IBN BAZI etj]

--- Nëse nuk dihet se a e ka përmend emrin e Zotit, apo emrin e jesusit, origjina është që lejohet dhe mishi hahet, siç thotë Lexhnja (Komisioni i Përhershëm).

--- Nëse e di (me dëshmitarë të sigurt), apo e dëgjon vetë që e përmend emrin e jesusit, apo përmend trinitetin kur e ther bagëtinë, mos e ha mishin e saj.

- **Kasapi duhet të përmend emrin e atij që bën kurbanin.**

Të thotë: *"O All-llah! Ky (kurban) është nga filani."*

-- disa dijetarë thonë se edhe nëse nuk e përmend, kurbanit është i saktë (i vlefshëm).

- **Nuk lejohet t'i jepet kasapit asgjë prej kurbanit si shpërblim (apo pagesë) për therjen.**

MISHI I KURBANIT

- **Duhet të hash prej mishit të Kurbanit tënd.**

-- Thotë All-llahu - Subhaneh:

{فَكُلُوا مِنْهَا}

{Hani prej tij}

-- Disa dijetarë thonë: *"Është obligim."*

Shejh Albani thotë: *"Medoemos duhet të hash prej Kurbanit tënd."*

لا بد من ان تأكل من هذه الأضحية

-- Nëse ke bërë disa kurbane, duhet të hash prej të gjithave, sepse secila ka gjykim në vete.

-- Nëse ke shumë kurbane, merr prej të gjithave nga një copë, zieji në një tenxhere, ha dhe pi prej lëngut, siç ka bërë Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem.

-- Nuk ka masë të caktuar se sa duhet të hash.

- **Është detyrë (obligim) të bësh sadaka te nevojtarët me mishin e kurbanit tënd. [Shafiitë, Hanbelitë]**

Imam Neueuiu thotë: *"Është obligim."*

Ibn Uthejmini thotë: *"Është detyrë."*

Hanefitë dhe Malikitë thonë:

"Është e pëlqyer. Nuk është obligim."

Unë anoj te ajo që është obligim (detyrë), sepse tekstet kanë ardhur në formë urdhërore.

All-llahu thotë:

{فَكُلُوا مِنْهَا وَأَطْعَمُوا بِأَنْسَ الْفَقِيرِ}

{Hani prej tij dhe ushqeni nevojtarin}

Profeti sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

"كلوا و ادخروا و تصدقوا"

((Hani -prej kurbanit-, mbani -rezervoni-, dhe jepni sadaka -prej tij-))

[Bukhari/Muslimi]

-- Prej çdo Kurbanit që ke bërë (nëse ke bërë më shumë se një) duhet me dhënë nga një pjesë sadaka për nevojtarët, sepse secili ka gjykim në vete.

● Masa se sa duhet me dhënë sadaka.

Nuk ka argument në lidhje me këtë.

-- U jepet perparësi nevojtarëve që i ke të afërm.

-- E mira është t'u japësh atë ditë (ditën e Kurbanit) që të gëzohen edhe ata në atë ditë. Nëse nuk mundesh, bën edhe ditët tjera.

-- Nëse nuk u jep me qëllim, apo i prishet mishi prej neglizhencës së tij, dhe s'ka ç'farë t'i jape nevojtarit.. apo ia vjedhin nga neglizhenca e tij.. apo i dëmtohet nga neglizhenca e tij, dhe s'ka ç'farë t'i jape nevojtarit.. **obligohet me ble mish dhe me ia dhënë nevojtarit.**

[Neueui, Behuti - dijetar i madh Hanbeli, Ibn Uttejmini etj]

--- Nëse i demtohet mishi, jo nga neglizhenca, apo ia vjedhin, apo i bie në një vend ku nuk e nxjerr dot, pasi i ka marrë sebetpet, dhe nuk ka neglizhuar, në këtë rast nuk obligohet me gjë.

[Ibn Uttejmini]

-- MASA se sa me ble, nuk ka argument. Kjo kthehet te URFI.

Ajo që njihet ne URF (tradi tën e popullit) është NJË E ZIER në një tenxhere. Dhe kjo varet se sa anëtarë janë.

● NDARJA E MISHIT NË TRE PJESË

Disa dijetarë thonë:

"Pëlqehet që një të tretën t'a mbash, një të tretën t'a japësh sadaka dhe një të tretën t'a dhurosh."

Shejh Albani (All-llahu e mëshiroftë) thotë:

"Nuk ka argument për ndarjen e mishit në tre pjesë të barabarta. Ka argument me e nda në tre pjesë, por jo me një të tretën (dmth: jo ndarje të barabarta)."

Ndarja pëlqehet në tre pjesë duke u bazuar te hadithi: ((HANI, REZERVONI, DHE JEPNI SADAKA))

Disa dijetarë thonë:

“E ndan në dy pjesë: gjysmën për vete dhe gjysmën për nevojtarët.”

Edhe kjo nuk ka argument.

Ajo që ka argument është:

“Të hash vetë dhe familja. Të mbash (rezervosh), të japësh sadaka dhe të japësh dhuratë.”

Pastaj se si e ndan, sa kile për vete, sa kile për sadaka dhe sa kile dhuratë, nuk ka argument.

-- Është mirë t'i dhurosh komshiut, edhe nëse është qafir.

-- Edhe atij që është i pasur lejohet t'i dhurosh mish Kurbanit.

-- Edhe qafirit lejohet me i dhënë mish Kurbanit. [Ibn Utnejmini]

● **Ai i cili t'a ther kurbanin tënd, lejohet me ngrënë prej kurbanit tënd.**

Është e ndaluar t'a paguash (t'a shpërblesh) nga mishi, apo pjesë tjera të Kurbanit për therjen.

● **Nuk lejohet të shesësh diçka prej kurbanit.** [Ibn Utnejmini etj]

● **Nuk lejohet t'a ndërrosh mishin e Kurbanit, lekurën, apo pjesë tjera me diçka, ç'farëdo qoftë ajo.**

[Ibn Utnejmini]

● **Hedhja e lekurës së Kurbanit - Nuk bën t'a hedhësh (t'a gjuash) lëkurën e Kurbanit.**

--Është mirë t'a japësh sadaka.

--Ose t'ia dhurosh dikujt.

--Nëse nuk gjen njeri, apo nuk e merr njeri, e shet dhe paratë e saj i jep sadaka.

--Nëse nuk e shet dot, atëherë s'ka problem t'a gjuash (t'a hedhësh) në mbeturina.

● **Personi (nevojtar, apo i pasur) i cili ka pranuar (ka marrë) mish Kurbanit nga tjetri, lejohet t'a shesë, sepse tani mishi ka kaluar në pronësi të tij, dhe i lejohet të bëjë me pronën e tij ç'farë të doje (kuptohet: brenda kufijve të shariatit).**

[Ibn Utnejmini]

All-llahu e di më së miri

Ai është më i Dijshmi

و الحمد لله رب العالمين

و صلى الله على نبينا محمد وعلى آله وصحبه و سلم